




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRA	
02 Nr./Bc.	10 / 18
Nr./Bp./Iakt.	
Data/ Datim.	04.01.2018
VUSHTRRI - VUČITRA	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim caktohen zyrtarët komunal të cilët do të ndjekin aftësimet profesionale për përdorim të pajisjeve në objektin e ri të komunës si dhe instalimet tjera në këtë përbërje:

- 1.1 Z. **Skender Oshlani**, nxemje qendrore,
- 1.2 Z. **Liridon Lahu**, Teknologji informative,
- 1.3 Znj. **Shqipe Gashi** dhe Z. **Latif Beqiri**, elektrikë dhe ashensori
- 1.4 Z. **Mustafa Xhoni**, mbrojtje nga zjarri

2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake do të marr pjesë në aftësimet profesionale të cilat do të i organizon Operatori Ekonomik (kompania punëkryese) i cili i ka krye punët deri në finalizim, në objektin e ri të Komunës në Vuçitër. Lidhur me kohën dhe vendin e mbajtjes së trajnimeve do të njoftoheni nga operatori ekonomik.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi iu dërgohet: Operatorit Ekonomik, të lartpërmendurve dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



Shoqata Humanitare Bëmirëse e Kosovës "Nëna Tereze"
The Kosova Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"
Humanitarno Dobrotvorno Udruzenje Kosova "Majka Tereza"

38400 Prishtinë Rr. Agim Ramadani pn. Tel:00381 38 542 864, Fax:542 869,
Web site: www.nenatereze.org e_mail:ntereze@yahoo.com

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VOŠTINA	
02 Nr. / Bc	13/18
Nr. i fq. / Bc. sh	-02-
Data / Datum	10.01.2018
VUSHTRRI - VOŠTINA	

Bazuar në Projektin:

**"Nxitja e Asistencës Riintegruese për të kthyerit,
masat parandaluese ndaj migracionit të parregullit"**

Republika e Kosovës Kuvendi Komunal i Vushtrri përfaqësuar nga Z. Xhafer Tahiri – Kryetar

dhe

SHHBK "Nëna Tereze" - Prishtinë, përfaqësuar nga Zef Shala - Drejtor Ekzekutivë

Nënskruajnë këtë

Memorandum të Mirëkuptimit

Shoqata Humanitare Bëmirëse e Kosovës "Nëna Tereze" (SHHBK) është organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 1990.

Që nga ajo kohë ajo punon në uljen e varfërisë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës pa dallim feje, race gjinije apo përkatësi kombëtare, duke i ofruar ndihma në të mira materiale apo edhe përmes programeve zhvillimore "Ekonomi familjare" duke u munduar që të ju ndihmojë në sigurimin e ekzistencës së tyre.

Përveq kësaj SHHBK "Nëna Tereze" është duke u marrë edhe me problemin e Emigracionit i cili u aktualizua me të madhe nga viti 2014 e kendej. Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme Departamentit për Riintegrim të personave të Riatdhesuar dhe SHHBK "Nëna Tereze" ka Memorandum Mirëkuptimi nënskruar date 21.08.2015 dhe është duke u koordinuar me qëllim të përkrahjes së personave të kthyer.

Qëllimi i përgjithshëm i projekti "Nxitja e Asistencës Riintegruese për të kthyerit, masat parandaluese ndaj migracionit të parregullit" është të kontriboj në parandalimin e emigrimit si dhe Riintegrimin e të Riatdhesuarve gjerë me tani përmes formave të ndryshme të përkrahjes ,në të mire të krijimit të kushteve të qëndrueshme jetësore në vënd.

Andaj I nderuari Zt. Kryetar në menyrë që të kemi një kordinim sa më të mire në teren, SHHBK Nëna Terezë ka nevojë të bashkpujoj me institucionet Komunale te Komunës suaj , posaqerishtë me

- Zyra Komunale për kthim dhe komunitete si dhe
- Drejtorija Komunale për shëndetesi dhe mirqenje sociale


E gjithë kjo me qellim që të kemi një koordinim më efikas në pergjithësi, sidomos rreth shkembimit të informacioneve të nevojshme për sa l perket identifikimit e te kthyerve, por edhe të atyre qe jane në nje gjendje te rende sociale.

SHHBK " Nëna Tereze" permes zyrtareve te institucioneve te larte permendura te Komunes suaj kohe pas kohe do ju njoftoi me te gjitha te arriturat e ketij projekti.

Nënshkruar nga:


Republika e Kosovës
Komuna e Vushtrri

Z. Xhafer Tahiri – Kryetar




SHHBK "Nëna Terezë"

Z. Zef Shala - Drejtor Ekzekutivë



Xhafer Tahiri, data 10 / 01 / 2018



Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës "Nëna Tereze"
The Kosova Humanitarian and Charitable Society "Mother Tereza"
Humanitarno Dobrovolvorno Udruzenje Kosova "Majka Tereza"

38400 Prishtinë Rr. Agim Ramadani pn. Tel:00381 38 542864, Fax: 542869,
Web site: www.nenatereze.org e_mail:ntereze@yahoo.com

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUSHTRRI

02 Nr. / Br. 13/18
Nr. llog. / Br. sh. - 02 -
Data / Datum 10. 01. 2018

VUSHTRRI, VUSHTRRI

Based on the Project:

**"Fostering Reintegration Assistance to Returnees,
Prevention Measures to Irregular Migration"**

Republic of Kosovo Municipality of Vushtrri represented by Mr. Xhafer Tahiri – President

and

KHCS "Mother Teresa" – Prishtina represented by Mr. Zef Shala - Executive Director

Conclude this

Memorandum of Understanding

The Kosova Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa" (KHCS) is a non-governmental organization founded in 1990, since then works on reducing poverty for all citizens of the Republic of Kosovo, regardless of religion, race or national affiliation, by offering means, training and education to ensure socio economic wellbeing of its citizens.

Moreover in response of recent migration developments "Mother Teresa" (KHCS) is also dealing with the issues of Immigration, since 2014. The Government of the Republic of Kosovo through the Ministry of Internal Affairs, Department for Reintegration of Repatriated Persons and (KHCS) "Mother Theresa" has a Memorandum of Understanding signed on 21.08.2015 in support of the returnees' solid reintegration.

The overall purpose of the project " *Fostering Reintegration Assistance to Returnees, Prevention Measures to Irregular Migration* is: "to reduce migration pressure and create viable sustainable-based reintegration opportunities for returnees and non-returnees in Kosovo. The specific objective I to increase skills and competences of beneficiaries/returnees, increases entrepreneurship, self-employment and employability and generates lasting improvements in the well-being of returnee and potential migrants in the seven (7) geographic areas of Kosovo (Prishtina, Mitrovica, Peja, Prizreni, Ferizaj, Gjilani, Gjakova).

Therefore Dear Mr. Mayor in order to have a better coordination on the ground, (KHCS) "Mother Theresa" needs to cooperate with the Municipal Institutions of your municipality, especially with:

- Department of Health and Social Welfare
- Municipal Office for Returns and Communities.

In order to have a more efficient coordination in general, especially about the exchange of necessary information regarding the identification of returnees and those who are in a serious social condition.


The Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa" through the officials of the above mentioned institutions of your municipality from time to time will let you know all the achievements of this project.

Signed by:


Republic of Kosovo
Municipality of Vushtrri
Mr. Xhafer Tahiri, President



KHCS "Mother Teresa"
Prishtina
Mr. Zef Shala - Executive Director



_____, date ____ / ____ /2018



Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës "Nëna Tereze"
The Kosova Humanitarian and Charitable Society "Mother Tereza"
Humanitarno Dobrotvorno Udruzenje Kosova "Majka Tereza"

38400 Prishtinë Rr. Agim Ramadani pn. Tel:00381 38 542 864, Fax:542 869,
Web site: www.nenatereze.org e_mail:ntereze@yahoo.com

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUCITRAN

02 Nr. / Nr. 13/18
Nr. llog. / Llog. Nr. - 02 -
Datat / Datum 10. 01. 2018

VUCITRAN, VUCITRAN

Na osnovu Projekta:

**"Podsticanje podrške reintegraciji povratnicima,
mjerama za prevenciju neredovne migracije"**

Republika Kosovo, Opština Vucitrn, predstavljani G. Xhafer Tahiri – predsednik

i

HDUK "Majka Tereza" – Priština, predstavljani G. Zef Shala - izvršni director

Potpisuju

Memorandum o razumevanju

Humanitarno Dobrotvorno Udruženje Kosova "Majka Tereza" (HDUK) je nevladina organizacija osnovana 1990. godine. Od tada radi na smanjenju siromaštva za sve građane Republike Kosovo, bez obzira na religiju, rasnu pripadnost ili nacionalnu pripadnost, nudeći materijalnu pomoć ili kroz razvojne programe "porodična ekonomija" pokušavajući da vam pomognem da osigurate njihovo postojanje.

Osim toga, "Majka Tereza" (HDUK) također se bavi problemom imigracije, koji je najsavremeniji od 2014. godine. Vlada Republike Kosovo preko Ministarstva unutrašnjih poslova, Odsjek za reintegraciju repatriranih lica i (HDUK "Majka Tereza") ima potpisan Memorandum o razumevanju 21.08.2015. u koordinaciji kako bi podržao povratnike.

Opšta svrha projekta "Promocija pomoći za reintegraciju povratnika, preventivne mjere protiv neregularne migracije" je da doprinese sprečavanju migracija, kao i reintegraciji daljih prisutnih u različitim oblicima podrške, kako bi stvorio održive uslove života u zemlji.

Stoga, Poštovani gospodine predsedavajući, da bi se bolje koordinirali na terenu, HDUK "Majka Tereza" treba da sarađuje sa opštinskim institucijama vaše opštine, posebno sa:

- Odeljenje za zdravstvo i socijalno staranje
- Opštinska kancelarija za povratak i zajednice.

Sve to u cilju efikasnije koordinacije uopšte, posebno o razmjeni potrebnih informacija u vezi sa identifikacijom povratnika i onih koji su u ozbiljno socijalno ugroženom stanju.


Humanitarno Dobrotvorno Udruženje Kosova "Majka Tereza" (HDK) preko službenika pomenutih institucija vaše opštine povremeno će vas obavestiti o svim dostignućima ovog projekta.

Potpisali:

Republika Kosovo

Opština Vucitrn

G. Xafer Tahiri – predsednik




HDK "Majka Tereza"


Priština

G. Zef Shala - izvršni direktor



_____, dana ____ / ____ / 2018





Ndërmarrja Publike Qendrore
Posta e Kosovës Sh.A.

PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošta Kosova D.D.

KONTRATA PËR KRYERJEN E SHERBIMEVE POSTARE / No./Br. 01-165/18
Data/Date/Datum 19-01-2018
PRISHTINË-PRISTINA-PRISTINA

Kjo Kontratë lidhet në mes të:

1. **Posta e Kosovës SH.A.** Adresa; rr. 28 Nëntori, nr. 4, 10,000, Prishtinë, Kosovë.
Me numër të biznesit (70847701). E përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor
z. **Sejdi Hoxha**, Kryeshef Ekzekutiv i PK SH.A., në tekstin e mëtejme :
Kryesi i Shërbimeve, dhe
2. **Komuna e Vushtrrisë.** Adresa: objekti i komunës, Vushtrri. Te cilën e
përfaqëson z. **Xhafer Tahiri** – Kryetar i Komunës. : ne tekstin e mëtejme:
Porositësi i Shërbimeve.

NDËRSA:

Duke marrë parasysh konsideratat dhe kushtet e premtimet reciproke të parashtruara këtu, personi tjetër juridik i identifikuar në faqen e nënshkrimeve të kësaj Kontrate kryerjen e shërbimeve Postare i identifikuar si, “Kryesi i Shërbimeve” dhe personi tjetër juridik i identifikuar në faqen e nënshkrimeve të kësaj Kontrate si Porositësi i Shërbimeve bien dakord si vijon:

Kontrata për Kryerjen e Shërbimeve Universale Postare.

1. PËRKUFIZIME

Në këtë Kontratë, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtme kanë kuptimet e dhëna më poshtë:

KONTRATË : do të thotë kjo marrëveshje, me ndryshimet e herëpashershme.

AFAT : ka kuptimin e dhënë në Nenin 2.

KRYESI I SHËRBIMEVE : do të thotë : Posta e Kosovës SH.A. (PK SH.A)

POROSITËSI I SHËRBIMEVE : do të thotë : Komuna e Vushtrrisë

OPERATOR PUBLIK POSTAR : person juridik (Posta e Kosovës Sh.A) i licencuar për ofrimin e shërbimeve universal postare.

SHËRBIM POSTAR : Shërbimet e kryera me pagesë për dërgimin e dërgesave të postës së letrave, pakove, urdhërpagesave si dhe shërbimet e kryera me pagesë të cilat sigurohen nëpërmjet mjeteve për pranimin dhe dërgimin e dërgesave postare.

SHËRBIM UNIVERSAL POSTAR : shërbimet e kryera me pagesë për dërgimin e dërgesave të thjeshta postare deri në dy (2) kg, pakove deri në njëzetë (20) kg, shërbimet e urdhërpagesave dhe shërbimet e veçanta për dërgesat e regjistruara.

DËRGESË E THJESHTË POSTARE : çdo dërgesë postare që nuk regjistrohet ose shoqërohet me ndonjë shërbim të veçantë.

SHËRBIM I VEÇANTË POSTAR : shërbimet me të cilat dërguesi kërkon mënyrë të veçantë të dërgimit, bartjes dhe dorëzimit të dërgesës, ndryshe quhen dërgesat të regjistruara, (dërgesë e porositur"R", dërgesë me fletkthesë"AR", dërgesë me kundërpagesë, shërbimi i shpejtë postar"EMS", etj).

ZYRË POSTARE : hapësirën punuese në të cilën operatori postar ofron shërbime postare

TARIFA POSTARE : ka kuptimin e çmimores së shërbimeve postare, te aprovuar nga rregullatori (ARKEP).

PERSONAT KONTAKTUES: ka kuptimin e personit me të cilin bëhen kontaktet në lidhje me zbatimin e mirëfilltë të kësaj kontrate.

2. AFATI I BASHKËPUNIMIT.

2.1. Kjo Kontrate fillon në datën **01/02/2018**, dhe është e vlefshme për një periudhë kohore një(1) vjeçare, përkatësisht deri me datën **31/01/2019**, me mundësi vazhdimi, përveç rastit kur është fjala për zgjidhje të parakohshme të kësaj kontrate, sipas marrëveshjes së palëve kontraktuese.

2.2. Zgjidhja e kontratës është e mundur edhe nëse dispozitat ligjore mbi shërbimet postare e parashohin një mundësi të tillë.

2.3. Personat Kontaktues nga porositi i shërbimeve, do të jënë: znj. **Saranda Cakaj**, email saranda.cakaj@rks-gov.net, dhe nga kryesi i shërbimeve, znj. **Fitore Berisha**, nr. tel; +37745270060, apo edhe nga **Shitja - PK Sh.A**, nr. tel; 038534478.

3. DETYRIMET E PALËVE

3.1. Palët kontraktuese janë marrë vesh që lënda e kontratës të jetë; Pranimi dhe dorëzimi i dërgesave postare në adresën e destinimit.

3.2. Kryesi i shërbimeve obligohet të bënë Pranimin e objekteve postare dhe dorëzimin e këtyre objekteve Postare nëpërmjet formularit - Librit të pranimit.

3.3. Porositi i Shërbimit në mënyre alternative mund të regjistroj dërgesat online përmes web faqes www.postakosoves.com, në rubrikën **KLIENTËT** (regjistrimi i dërgesave), para se ti dorëzoj në mënyre fizike në zyrën postare të PK Sh.A.

3.4. Kryesi i shërbimeve obligohet që objektet postare t'i dorëzojë në afat në adresën e marrësit, sipas procedurave të parapara ligjore dhe udhëzimeve mbi pranim-dorëzimin e dërgesave postare, kurse për dërgesat postare të pa dorëzuara të ceket arsyeja e mosdorëzimit dhe t'i kthehen marrësit të vulosura dhe të konstatuara.

3.5. Kryesi i shërbimeve obligohet që të beje verifikimin se a përputhen të dhënat e shënuara në librin e pranimit me të dhënat e shënuara në dërgesa (dërgesa postare) dhe të shënojë taksën për secilën dërgesë.

3.6. Porositësi i shërbimit obligohet që të gjitha dërgesat Postare nga veprimtaria e kryesit të shërbimit t'i dorëzojë në Zyrat Postare të Postes së Kosovës.

3.7. Porositësi i shërbimit obligohet që në dërgesat e veta nuk do të vejë materiale dhe sende bartja e të cilave është e ndaluar sipas Ligjit mbi shërbimet postare.

4. KUSHTET E PAGESËS:

4.1. Kryesi i shërbimeve për shërbimet e bëra nga neni paraprak i kësaj kontrate përmes faturës ja faturon taksën në fund të muajit për muajin paraprak në pajtim me tarifën postare në fuqi të aprovuar nga ARKEP për llojin e shërbimit që parashihet si produkte të Postës,

4.2. Faturimi do të bëhet sipas ofertës së prezantuar dhe në përputhje me çmimoret që është e aprovuar

4.3. Në rastet ku gjatë afatit kontraktues me ndonjë vendim institucional nga rregullatori apo operatori publik kemi ndryshim të tarifave të shërbimeve postare, konsumatori obligohet që të paguaj faturat sipas këtyre tarifave të ndryshuara.

4.4. Posta e Kosovës do të aplikoj zbritje nga tarifa bazë e miratuar, bazuar në Vendimin për politikën e Diskontit/Zbritjes, Nr. 01-1890/15, të datës; 21/08/2015, si për dërgesat vendore brenda territorit të R. Kosovës, ashtu edhe për dërgesa ndërkombëtare, varësisht prej numrit të sasive të dërgesave brenda një(1) viti kalendarik.

4.5. Porositësi i shërbimit obligohet që pagesën për taksën postare dhe shërbimin e kryer të bëjë në llogarinë bankare të Postës së Kosovës SH.A. sipas faturës së dorëzuar, në afat prej 15 ditëve me shenjen për të hyrat e "Posta e Kosovës SH.A".

4.6. Kryesi i shërbimeve postare kryhen shërbimet postare sipas tarifës/çmimores në fuqi të miratuar nga ARKEP-i (Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare), të cilën mund të gjeni në web-faqen: www.postakosoves.com

5. ZGJIDHJA E KONTRATES:

5.1 Kontrata fillon me rastin e nënshkrimit nga të dyja palët dhe është e vlefshme në afat prej 1 viti, me mundësi vazhdimi,

5.2. Para skadimit të afatit të kontratës 30 dite përpara duhet të shqyrtojnë mundësinë e vazhdimit të kontratës dhe bashkëpunimit, me kërkesën paraprake me shkrim për vazhdim nga ana e porositësit të shërbimit.

5.3. Palët kontraktuese mund të zgjidhin kontratën edhe para përfundimit të afatit në piken 2.1. duke e njoftuar njëra tjetrën se nuk dëshirojnë të vazhdojnë bashkëpunim, me kërkesën me shkrim 30 dite përpara.

5.4. Secila palë mund të ndërpresë njëanshëm kontratën për kryerjen e shërbimeve postare, brenda afatit kontraktues, kurdo që e vlerëson se ka efekte negative afariste, duke njoftuar njëra tjetrën me shkrim brenda afatit prej 15 ditësh.

6. NDRYSHIMI I STATUSIT

6.1. Kryesi i Shërbimeve rezervon të drejtën e plotë të transferojë këtë Kontratë në rastin e ndryshimit të pronësisë pasardhësve të tij ose ndonjë subjekti të tij ndaj çdo Kompanie, pa qenë nevoja të marrë miratimin e Porositësit të Shërbimeve, dhe ky transferim do të bëhet efektiv në datën kur Kryesi i Shërbimeve i jep njoftim Porositësit të Shërbimeve.

6.2. Ndryshimet ndaj kësaj Kontrate mund të bëhen vetëm me shkrim, me nënshkrime të përfaqësuesve të autorizuar të secilës palë ose pasardhësve të tyre,

6.3. Çdo çështje e patrajtuar në këtë Kontratë do të zgjidhet me pajtimin dhe shqyrtimin e palëve kontraktuese në përputhje me Ligjin mbi Shërbimet Postare.

7. PËRGJEGJËSIA

7.1. Operatori publik Postar, të gjitha shërbimet nga veprimtaria e tij, do ti trajtoj në përputhje me Ligjin për shërbime Postare Nr. 03/L-173, dhe Udhëzimin administrativ Nr 2005/4/02.

7.2. Shërbimi postar ndërkombëtar realizohet në përputhje të plotë me dispozitat e ligjit Nr. 03/L-173, dhe aktet e Unionit të Përgjithshëm Postar dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me shërbimet postare.

7.3. Kryesi i Shërbimeve do të jetë përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar mbi pajisjet për shkak të akteve ose mosveprimeve të tij nga pakujdesia keqshfrytëzimi ose keqpërdorimi prej anëtarëve të personelit të tij i natyrës penale, qoftë ky i prekshëm ose i paprekshëm në secilin prej rasteve të lartpërmendura që ndodh gjatë përmbushjes ose në lidhje me përmbushjen e kësaj Kontrate. Kryesi i Shërbimeve nuk mban përgjegjësi nëse këto janë të natyrës që përshkruhet në Nenin 8 (Forcë Madhore).

7.4. Çdo dërgesë postare që është objekt reklamacioni do të trajtohet sipas ligjeve dhe akteve nënligjore që janë në fuqi në kohën e paraqitjes së reklamacionit.

8. FORCA MADHORE:

8.1. Nëse, në çdo kohë, gjatë Afatit të kësaj kontrate përmbushja plotësisht ose pjesërisht nga secila Palë e çdo detyrimi sipas kësaj kontrate pengohet ose vonohet për shkak të luftës, luftës civile, armiqësisë, akteve të armikut publik, rebelimit, revolucionit, fuqisë ushtarake ose të uzurpimit, shqetësimeve civile, demonstratave ose kërcënimeve të menjëhershme lidhur me gjithë si më lart, sabotazhit, zjarrit, përmytjes, shpërthimeve, epidemive, kufizimeve për shkak të karantinës, shqetësimeve në furnizime nga burime normalisht të besueshme (ku përfshihen por jo vetëm elektricitet, ujë, naftë dhe të ngjashme), greva, përjashtime, vendime qeveritare ose ndonjë ngjarje tjetër jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës në fjalë (këtu e më poshtë e përmendur si "ndodhia"), atëherë përmbushja e këtyre detyrimeve do të falet në masën që u pengua ose u vonua dhe pala e prekur ka marrë njoftim për këtë ndodhi nga Pala tjetër brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e ndodhisë duke pasur parasysh që ngjarja e e çdo ndodhie nuk justifikon asnjë detyrim të secilës Palë për të kryer pagesa. Asnjëra Palë, për shkak të ndodhisë, nuk ka të drejtë të zgjidhë këtë kontrate ose të ngrejë pretendime për dëme kundër palës tjetër në lidhje me mos-përmbushjen ose vonesën në përmbushje. Përmbushja e detyrimeve të cenuara duhet të rifillojë sapo të jetë praktike pas përfundimit ose pushimit të ndodhisë në fjalë. Nëse përmbushja tërësisht ose pjesërisht e ndonjë detyrimi sipas kësaj kontrate vonohet për shkak të ndonjë ndodhie të tillë për një periudhë që tejkalon tre (3) muaj, Palët do të takohen dhe rishikojnë në mirëbesim dëshirueshmërinë dhe kushtet për zgjidhjen e kontratës.

9. MARRËVESHJA E PLOTË:

9.1. Palët pohojnë dhe bien dakord se gjithë marrëveshjet dhe mirëkuptimet mes tyre marrin fund që prej datës efektive të kësaj kontrate: me kusht, që të gjitha shumat që

përbëjnë detyrim ndaj secilës Palë sipas marrëveshjes së mëparshme mbeten ende detyrime dhe të pagueshme.

10. LIGJI DHE JURIDIKSIONI:

10.1 Për çështje të cilat nuk janë rregulluar në këtë kontratë dhe në rast të kontestit të mesazheve do të vlejë dispozitat e ligjit mbi marrëdhëniet detyruese, ku kompetentë do të jetë Gjykata Themelore e Prishtinës -Departamenti i Përgjithshëm.

10.2 Në rast të çdo mosmarrëveshjeje që lind për shkak ose në lidhje me përmbushjen ose interpretimin e kësaj kontrate, Palët bien dakord të takohen dhe të negociojnë në mirëbesim për të arritur një zgjidhje miqësore, në mungesë të së cilës, vendimin për zgjidhje të mosmarrëveshjes do të ndërmarrin veprimet ligjore sipas pikës 10.1.

10.3 Kjo Kontratë hartohet dhe nënshkruhet në tre (3) kopje origjinale, një (1) për palë kontraktuese, dy (2) për PK Sh.A.

NËNSHKRUHET PËR DHE NË EMËR TË KRYESIT TE SHERBIMEVE


z. Sejdi Hoxha - Kryeshf. Ekzekutiv, PK SH.A.

Datë: 19.01.2018

NËNSHKRUHET PËR DHE NË EMËR TË POROSITESIT TE SHERBIMEVE


z. Xhafer Tahiri – Kryetar i Komunës, Komuna e Vushtrrisë.

Datë: 10/01/2018

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA SERBIA
KOMUNA E VUSHTRRIS - OPSTINA VUSHTRRI


№ (K.)/... 33/18

№ (L.)/...

Datë / Datum 11.01.2018



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës jep këtë:

U R D H Ë R E S Ë

1. URDHËROJ Drejtorët e Drejtorive të shënuara si më poshtë, që të aplikojnë masat e kushtëzimit të pagesës së tatimit në pronë për shërbimet e kryera ndaj qytetarëve, bizneseve etj. të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Financave Nr.07/2011 për Urdhëresat e Ndalimit të Shërbimeve Komunale për Detyrimet e Pagesës së Tatimit në Pronë. (neni 3-6 i UA në fjalë):
 - 1.1 Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit,
 - 1.2 Gjeodezi Kadastër dhe Pronë,
 - 1.3 Ekonomi bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural,
 - 1.4 Buxhet dhe financa,
 - 1.5 Shërbime Publike dhe
 - 1.6 Prokurim Publik
2. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
3. Urdhëresa i dërgohet: Drejtorëve të Drejtorive nga pika një e kësaj urdhërese dhe Arkivit të Sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri






REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRAN

02 Nr. / 0e 34 / 18

Nr. / Epy. / Dik. st.

Data: / Datum 11. 01. 2018

VUSHTRAN - VUČITRAN




REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës jep këtë:

U R D H Ë R E S Ë

1. URDHËROJ Drejtorin e Drejtorisë për Inspektime që përmes inspektorëve të ndërtimtarisë të bëjë inspektimin e të gjitha objekteve shumëkatëshe banesore të ndërtuara gjatë vitit 2016 dhe 2017 në Komunën e Vushtrrisë nëse janë të pajisura me leje ndërtimore gjegjësisht nëse iu kanë përmbajtur lejeve ndërtimore për ato objekte. Me rastin e zhvillimit të inspektimeve sipas nevojës duhet bashkëpunuar ngushtë me Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
2. Lidhur me gjendjen e konstatuar duhet të informohem me shkrim brenda afatit sa më të shkurtër të mundshëm.
3. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Urdhëresa i dërgohet: Drejtorit për Inspektime dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA NGARVO
KOMUNA E VUSHTRRIŠË - OPŠTINA VUŠTRRIŠA

02 Nr. / Bv. 41/18

Nr. / fq. / Bv. sh.


Date / Datum 11.01.2018

VUŠTRRIŠA - VUŠTRRI



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI


Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) NR. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR ANULIM TË KONKURSIT

1. Anulohet konkursi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Vushtri nr.1347/17, dt. 05.12.2017 për plotësim të vendeve të lira të punës si vijon:
 - 1.1 Doktor i Stomatologjisë - dy pozita,
 - 1.2 Shef i Shërbimit Juridik - një pozitë,
 - 1.3 Infermier-e - tre pozita,
 - 1.4 Shtëpiak - dy pozita dhe
 - 1.5 Shef për buxhet dhe financa – një pozitë
2. Anulimi i këtij konkursi bëhet për shkak se nuk janë respektuar procedurat sipas nenit 4 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) NR. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.
3. Me rastin e rishpalljes së konkursit kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin që anulohet, nuk kanë nevojë që të sjellin dokumentacion tjetër të kërkuar me konkursin e rishpallur përveç aplikacionit për punësim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit të Komunës dhe QKMF në Vushtri.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
6. Vendimi i dërgohet: Zyrës së Personelit, Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale Zyrës së Informimit, QKMF-së dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri




REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPÉTTINA VUÇITRA

07 Nr. / Br. 44 / 18

Nr. I Sq. / Nr. sh.

Data / Datum 11.01.2018

VUŠITRIM - VUÇITRIM




REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KËSHILLIT ORGANIZATIV

1. Formohet Këshilli Organizativ për shënimin e 17 shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës në këtë përbërje:
 - 1.1 **Besim Muzaqi**, Nënkryetar i Komunës - Kryesues i këshillit
 - 1.2 **Afrim Namani**, Drejtor për Arsim - anëtar
 - 1.3 **Saranda Cakaj**, Drejtore për Prokurim - anëtar
 - 1.4 **Sedat Rashica**, Drejtor për Shërbime Publike - anëtar
 - 1.5 **Mehmet Selaci**, Drejtor për Administratë - anëtar
 - 1.6 **Izet Miftari**, Zyrtar përgjegjës në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport - anëtar
2. Këshilli organizativ nga pika paraprake e këtij vendimi do të ndërmerë të gjitha veprimet e nevojshme për organizim të shënimit sa më solemn të kësaj date të rëndësishme.
3. Kryesuesi i Këshillit organizativ të këtij manifestimi do të raportoj saherë të jetë e nevojshme në takimet e rregullta javore me drejtor të drejtorive lidhur me përgatitjet për këtë manifestim si dhe mbarëvajtjen pas përfundimit të shënimit të kësaj date.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet: Anëtarëve të Këshillit Organizativ dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRI - КОМУНА ВУШТРИ

02 Nr / Nr 45 / 18


Nr. i Sq. / Broji

Data / Datum 11.01.2018

VESHITIME / ZHËRTIME




REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës jep këtë:

U R D H Ë R E S Ë

1. URDHËROJ Drejtorin e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të rishikoj të gjitha lejet e lëshuara brenda vitit 2017 në veçanti lejet nga fillimi i fushatës zgjedhore komunale në muajin tetor përkatësisht nëntor 2017.
2. Lidhur me gjendjen e konstatuar duhet të informohem me shkrim brenda afatit sa më të shkurtër kohorë.
3. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Urdhëresa i dërgohet: Drejtorit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPŠTINA VUÇITRRI

Gj. Nr. / Rr. 62 / 18

Nr. / Rr. / Ad. /

Datim / Datum 16.01.2018

VUSHTRRI - VUÇITRRI




REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:



V E N D I M
PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR ADMINISTRATË

1. Me këtë vendim formohet grupi punues për administratë – për sektorin e zyrës pritëse, për bashkëpunim me Komunën Vaxjo – Suedi, në këtë përbërje:
 - 1.1 **Mehmet Selaci**, kryesues i grupit
 - 1.2 **Fatmir Feka**, anëtar
 - 1.3 **Bekim Selmani**, anëtar
 - 1.4 **Xhavit Mehmeti**, anëtar
 - 1.5 **Ragbete Krasniqi**, anëtar
 - 1.6 **Liridon Lahu**, anëtar
2. Grupi punues në fjalë do të realizoj bashkëpunim sa më të suksesshëm me Komunën Vaxjo – Suedi në fushën e administratës e që është në interes të dy komunave.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 02nr.558/17, dt. 03.05.2017.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet: Anëtarëve të grupit punues, koordinatori nga Komuna Vaxjo, Suedi dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri




REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "c" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M
PËR FORMI TË KOMITETIT DREJTUES

1. Formohet Komiteti Drejtues i Komunës së Vushtrrisë për bashkëpunim me Komunën Vaxjo nga Suedia ka këtë përbërje:
 - 1.1 **Xhafer Tahiri**, Kryetar i Komunës
 - 1.2 **Nasuf Aliu**, Kryesues i Kuvendit të Komunës,
 - 1.3 **Melihate Basholli - Latifi**, Anëtare e Kuvendit Komunës (opozitë)
 - 1.4 **Saranda Cakaj**, Drejtore e Prokurimit
2. Komiteti drejtues do të veprojë në emër të Komunës së Vushtrrisë lidhur me të gjitha format e partneritetit dhe bashkëpunimit me Komunën Vaxjo nga Suedia duke garantuar parimin e përfitimit të dyanshëm (në mes të këtyre dy komunave).
3. Ky komitet do të realizojë vizita sipas nevojës në Komunën Vaxjo për të realizuar bashkëpunim sa më të suksesshëm në fusha të ndryshme, për të cilat do të arrihen marrëveshjeve të përbashkëta.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 02nr.1059/15, dt.09.10.2015.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
6. Vendimi iu dërgohet: të lartë përmendurve, koordinatorit nga Komuna Vaxjo dhe arkivit të sekretarisë.




Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI


Kryetari



Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:



V E N D I M

1. Lejohet regjistrimi i automjetit zyrtar të komunës (kamionetë dubelkabinë) e cila është në shfrytëzim nga "Qendra për Përkrahjen e Punësimit dhe Ruajtjen e Ambientit" në fsh. Bukosh të Komunës së Vushtrrisë. Të dhënat për automjetin: numri i regjistrimit 02Z-12-27, "Citoen", JUMPER, viti i prodhimit 2015, Dizel, 4 dyer, ngjyrë e bardhë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet shefi i autoparkut të komunës.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi i dërgohet: Shefit të autoparkut të komunës dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIM TË DELEGACIONIT PËR VIZITË ZYRTARE NË VAXJO – SUEDI

1. Me këtë vendim caktohet delegacioni të KK-së për vizitë zyrtare në Vaxjo – Suedi, në këtë përbërje:
 - 1.1 Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit
 - 1.2 Rrezarta Krasniqi, anëtare e kuvendit
 - 1.3 Sadije Bajgora, anëtare e kuvendit (opozitë)
 - 1.4 Berat Jonuzi, zyrtar – nëpunës civil i komunës
 - 1.5 Bastri Duraku, Sekretaria e kuvendit
 - 1.6 Faton Behrami, Asistent i kryesuesit të kuvendit
2. Qëllimi i kësaj vizite është që në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë në mes të Komunës Vaxjo – Suedi dhe Komunës së Vushtrrisë të i këmbëjnë përvojat në fushën e funksionimit të kuvendeve të këtyre dy komunave duke i shfrytëzuar njohuritë dhe përparësitë e punës në kuvend, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, ngritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendim marrjes etj.
3. Realizimi i vizitës do të bëhet nga data 25.02-02.03.2018.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi iu dërgohet: Personit të autorizuar të komunës Vaxjo, anëtarëve të delegacionit dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOMUNO
KOMUNA E VUSHTRISË - КОМУНА ВУШТРИС

02 Nr / No 101 / 18

Nr / No / Datum

Datë / Datum 23.01.2018

YBIRYNYTE, VUJON:





REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës me datën merr këtë:

V E N D I M
PER FORMIM TE KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për përgatitje të dokumentit “Studimi i Fizibilitetit për Themelimin e Zonës Ekonomike - Parku i Biznesit në Lummadh, në këtë përbërje:
 - 1.1 **Miran Halili**, kryesues,
 - 1.2 **Mexhit Perçuku**, anëtar
 - 1.3 **Haki Maloku**, anëtar
 - 1.4 **Liridon Lahu**, anëtar
2. Komisioni në përbërje të cekur nën pikën paraprake do të hartoj dokumentin “Studimi i Fizibilitetit për Themelimin e Zonës Ekonomike - Parku i Biznesit në Lummadh” të Komunës së Vushtrisë, konform standardeve të pranuar dhe dorëzoj Kryetarit të Komunës për procedim të të njëjtit në Ministri të Tregtisë dhe Industrisë, si një ndër kriteret e përcaktuara për marrje të pëlqimit për themelim të zonës ekonomike përkatësisht parkut të biznesit në këtë fshat.
3. Komisioni do të përgatis këtë dokument në një vend ku kushtet e punës mundësojnë qasje dhe përkushtim të duhur profesional për punë, e që ky vend mund të jetë Durrës, Shqipëri.
4. Komisioni duhet të filloj me punë menjëherë.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
6. Vendimi i dërgohet: anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë.

REPUBLICA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRISË
Kryetari i Komunës
Rej Xhafer Tahiri
Rej Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 22 të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Udhëzimin Administrativ të MEF-it nr.5/2003 dhe nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës si dhe propozimin e drejtorisë për buxhet dhe financa, Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT TË ANKESAVE

1. Formohet komisioni për shqyrtim të ankesave për tatim në pronën e paluajtshme për v. 2018 në këtë përbërje:
 - 1.1 Gjylsime Feka – Ferati, kryesuese
 - 1.2 Selim Pllana, anëtar
 - 1.3 Fadil Selimi, anëtar
2. Komisioni në fjalë do të shqyrtoj brenda afatit ligjorë të gjitha ankesat e obliguesve tatimor të Komunës së Vushtrrisë të cilët janë të ngarkuar me tatimin në pronën e paluajtshme për v. 2018, konform legjislacionit të zbatueshëm.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi iu dërgohet: Drejtorisë për buxhet dhe financa, anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë.

Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri






REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:



V E N D I M
P E R F O R M I M T E K O M I S I O N I T

1. Formohet komisioni për përgatitje të Draft Rregullore për Ndarje të Mjeteve nga Subvencionet dhe Transferet të Entiteteve Publike dhe Jopublike, në këtë përbërje:
 - 1.1 Albanez Tahiraj, nga Zyra Ligjore,
 - 1.2 Naim Ferizi, nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
 - 1.3 Shukrane Begu, nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport
2. Komisioni në përbërje të cekur nën pikën paraprake do të hartoj draftin e Rregullore për Përcaktimin e Kriteve të Ndarjes së Mjeteve nga Subvencionet dhe Transferet për Ndhmë Momentale Entiteteve Publike dhe jo Publike, për të e proceduar për mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës. Afati për dorëzim në Sekretari të Kuvendit të Komunës është data 09 mars 2018.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi i dërgohet: anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



Komuna Vushtrri

Këshilli i Bashkësisë Islame

Nr. 40/2018 Datë: 25.01.2018

Në bazë të nenit 12.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03 L-040 dhe nenit 41.2 "c" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, dhe vendimit të Kuvendit Komunal nr. 189/17 datë 29.06.2017 të marrë në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2017 për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, z. Xhafer Tahiri dhe Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame-Vushtrri, z. Shemsi Rrahimi, lidhin këtë:

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI PËR
KRYERJEN E RITEVE FTERAE TË VARRIMIT SI DHE SHËRBIMEVE DHE
CEREMONIVE FETARE PËRCJELLËSE**

Neni 1.

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në bazë të vendimit nr. 189/17 datë 29.06.2017 mbi mbulimin e shpenzimeve për kryerjen e riteve fetare të varrimit si dhe shërbimet përcjellëse të varrimit, autorizon dhe i jep në përgjegjësi Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtrri kryerjen e shërbimeve të varrimit në tërë territorin e komunës së Vushtrrisë.

Neni 2.

Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtrri obligohet që të kryejë ritet e varrimit si:

- Hapjen e varrit,
- Dërrasat
- Qefinin,
- Piramidat me mbishkrim,
- Transportin e kufomës,
- Pastrimin e kufomës, dhe
- Kryerjen e ritualeve të varrimit sipas traditave fetare.

Shpenzimet për të gjitha këto rite fetare do të përmbliidhen në një faturë që Bashkësia Islame do të përgatitë për Komunën, duke përfshirë emrin e personit që ka vdekur si dhe shërbimet që i ka kryer Bashkësia Islame (Hapja e varrit sipas parimeve fetare

islame pa arkivol; Transporti i kufomës brenda territorit të Vushtrrisë (nga shtëpia deri në xhami dhe prej aty në varreza dhe nga spitali (QKUK) në Prishtinë dhe aeroporti ndërkombëtar 'Adem Jashari; transporti i punëtorëve dhe mjeteve të punës; dezinfektimi i veturës; Dërrasat me të cilat mbulohet i vdekuri pas lëshimit në varr; Qefini përfshirë këtu edhe dorëzat higjienike, sapunin dhe pambukun; Piramida (dërrasa me mbishkrimin e të dhënave për të vdekurin); Pastrimi i kufomës nga personi i autorizuar; Shërbimi i imamit (kryerja komplet e ceremonisë mortore).

Shuma e faturës për ritet fetare të varrimit të cekura si më lartë është 210 € për një (1) person. Për çdo person do të përgatitet faturë e veçantë.

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 189/17 datë 29.06.2017, shpenzimet do të mbulohen nga data 01.01.2018.

Neni 3.

1. Komuna e Vushtrrisë obligohet që për ritet dhe shërbimet e varrimit të paguajë shumën e specifikuar në Nenin 2 e dhe e cila i dërgohet Komunës në fillim të çdo muaji për muajin paraprak më së largu deri më datë 05 të muajit vijues.
- 1.1. PAGESA E SHPENZIMEVE TË SHËRBIMEVE DUHET TË BËHET NGA DATA 01 DERI 05 TË MUAJIT VIJUES NË XHIROLLOGARINË BANKARE TË KBI-VUSHTRRI: NLB BANKA VUSHTRRI, KBI VUSHTRRI I BASHKESIS ISLAME I707-0010-II2350.02.

Neni 4.

Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtri obligohet që në fund të çdo muaji t'i raportojë Komunës së Vushtrrisë për rastet e vdekjeve si dhe të bëjë faturimin me kohë të faturave për pagesën e shërbimeve: faturën, evidencën e personave të vdekur dhe certifikatat nga libri amzë i të vdekurve.

Neni 5.

Memorandumi i Mirëkuptimit nuk e mbulon pagesa e anëtarësisë ndaj Bashkësisë Islame.

Neni 6.

Për shërbime shtesë që kërkohen nga qytetarët dhe të cilat nuk janë të parapara në këtë memorandum, ata obligohen t'i bartin individualisht shpenzimet.

Neni 7.

Memorandumi i Mirëkuptimit është i lidhur për afatin kohor një vjeçar me mundësi të vazhdimit dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët kontraktuese.

Neni 8.

Memorandumi i Mirëkuptimit mund të shkëputet njëanshëm nga ana e Komunës së Vushtrrisë me njoftim paraprak me shkrim në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh në rast se Këshilli i Bashkësisë islame nuk i respekton kriteret e respektuara në këtë memorandum apo në raste specifike dhe të arsyeshme.

Neni 9.

Çdo mosmarrëveshje apo pretendim që rrjedh apo lidhet me këtë memorandum zgjidhet me mirëkuptim mes palëve kontraktuese. Nëse nuk arrihet zgjidhja me mirëkuptim do të hapet kontest pranë Gjykatës kompetente.

Neni 10.

Çdo ndryshim i këtij memorandum miratohet me shkrim nga palët kontraktuese.


Neni 11.


Ky Memorandum i Mirëkuptimit është përpiluar në katër (4) ekzemplarë dhe do të ju dorëzohen nga dy kopje palëve.

Palët-nënshkrimi-vula
Vushtrri, dt. 15.01.2018


Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës së Vushtrrisë





Shemsi Rrahini
Kryetar i BLS së Vushtrri





Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

Kryetari i Komunës

Në bazë të nenit 82 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149 dhe në bazë të nenit 5 të rregullores nr.05/2011 për procedurat e zgjidhjes së kontesteve dhe ankesave, Kryetari i Komunës, bien:

V E N D I M


Për emërimin e komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave për shërbimin civil të komunës së Vushtrrisë

Me të cilin vendim emërohet komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave për shërbimin civil të Komunës së Vushtrrisë, në këtë përbërje:

1. Remzije Zekolli, kryesuese e komisionit
2. Fatmir Feka, anëtar i komisionit
3. Branislav Vuksanoviq, anëtar i komisionit


II. Komisioni ka mandat 2 vjeçar.

III. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
 INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
 INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA



Komuna Vushtri

ANEKS I për vitin 2018

II. Bashkëfinancimi i projekteve të IADK-së për vitin 2018

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Njësia	Nr. i përfituesve	Investimi €/përfitues	Totali €	Pjesëmarrja e partnerëve		
						IADK dhe Donatorët	Komuna	Përfituesit
1	Ngritja e pemishteve (arrë, dredhzë, mjedër) 0.2-1 ha	Fermer	7	2,000.00	14,000.00	8,400.00	2,800.00	2,800.00
	Total Direkte		7		14,000.00	8,400.00	2,800.00	2,800.00
2	Shpenzime operacionale (selektimi, këshilla, trajnime, monitorim, komunikim, materiale edukuese, raportim)				4,200.00	3,360.00	840.00	-
	Buxheti total				18,200.00	11,760.00	3,640.00	2,800.00

IADK	Komuna	Fermeri
65%	20%	15%

Investimi total në Komunë	18,200.00
----------------------------------	------------------

Mënyra e pagesës së bashkëfinancimit nga Komuna e Vushtrisë

- “Komuna e Vushtrisë” do t’i bëjë pagesën IADK-së për bashkëfinancim, pas implementimit të projekteve dhe dorëzimit të raportit final për projektet e lartë cekura, listën e përfituesve dhe kërkesës për pagesë, nga ana e IADK-së

Adresa:
 Fshati Sfarraqak i Ulët, p.n
 42000 Vushtri
 Kosovë/a

Të jetojmë nga toka dhe punojmë!
Let us live from our land and work!

E-mail: info@iadk.org
 Tel/Fax: +381 (0) 28 536 726
 Web: www.iadk.org



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA



Komuna Vushtri

- Pagesa do të bëhet në TEB Bankë në depozitim në Nr.xhir:2027-000021-7128-84, në emër të IADK-së
- Përzgjedhja e përfituesve do të bëhet nga komisioni i përbashkët i IADK-së dhe “Komuna e Vushtrrisë”, dhe kontratat për përfitim të projektit do të nënshkruhen nga tri palët (IADK, Komuna dhe përfituesi)


Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së

Kosovës (IADK)


Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv

Vushtri 30/01 2018

Komuna e Vushtrrisë


Xhafer Tahiri
Kryetar

Vushtri 30/01 2018




REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPŠTINA VUČITRIN

02 Nr / No ... 122 / 18

Nr / No / No / ...

Data / Datum ... 31.01.2018

VUČITRIN - VUČITRIN




REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

URDHËRESË

1. Urdhëroj drejtorin e shërbimeve publike që të ndaloj dhënien në shfrytëzim të automjeteve zyrtare të komunës për rastet e pjesëmarrjes në ceremonitë e varrimeve dhe ngushëllimeve, në Komunën e Vushtrrisë dhe jashtë saj.
2. Përfshij nga kjo pikë e kësaj urdhërese bën automjeti zyrtar i Kryetarit dhe nënkryetarit të komunës.
3. Për zbatimin e kësaj urdhërese obligohen: Drejtori për shërbime publike dhe shefi i autoparkut të komunës.
4. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Urdhëresa i dërgohet: Drejtorit për shërbime publike, shefit të autoparkut të komunës dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri